<p>1 të këtij neni, përcakton me një vendim nëse projekti i propozuar duhet t'i nënshtrohet procedurave për tu pajisur me pëlqim mjedisor. Në raste të jashtëzakonshme që kanë të bëjnë me natyrën, ndërlíkueshmërinë, vendndodhjen ose përmasat e një projekti, Komisioni i VNM-së mund t'a shtyjë afatin dhe njofton aplikuesin me shkrim për arsyet e shtyrjes dhe datën kur pritet përcaktimi. Kjo zgjatje e afatit nuk mund të jetë më e gjatë se nëntëdhjetë (90) ditë nga dita kur aplikuesi ka dorëzuar kërkesën për VNM.</p> <p>7. Vendimi për përzgjedhjen publikohet në tabelën e shpalljeve publike në komunë, përfshirë uebfaqen zyrtare të Ministrisë, apo ndonjë formë tjetër të përshtatshme, pesë (5) ditë nga data e nxjerrjes së vendimit. Vendimi publikohet në uebfaqen e Ministrisë brenda të njëjtit afat;</p> <p>8. Nëse dokumentacioni i bashkëngjitur në kërkesë nuk është i plotë, Ministria kërkon informacion dhe dokumentacion shtesë nga aplikuesi dhe cakton një afat të arsyeshëm për dorëzimin e tyre, por jo më shumë se tridhjetë (30) ditë. Nëse dokumentet dhe informacionet nuk dorëzohen brenda afatit të caktuar, Ministria e përfundon shqyrtimin e lëndës dhe e refuzon kërkesën.</p>	<p>paragraph 1 of this Article, by the decision determines whether the proposed project should be subject to EIA procedures to obtain environmental consent. In exceptional cases relating to the nature, complexity, location or size of a project, the EIA Commission may extend the deadline and notify the applicant in writing of the reasons for the postponement and the date on which the determination is expected. This extension of the deadline can not be longer than 90 days.</p> <p>7. The decision on the selection is published in the public notice bulletin in the municipality, including the official website of the Ministry, or any other suitable form, five (5) days from the date of issuing the decision. The decision is published on the Ministry's website within the same deadline;</p> <p>8. If the documentation attached to the application is not complete, the Ministry requests additional information and documentation from the applicant and sets a reasonable deadline for their submission, but not longer than 30 days. If the documents and information are not submitted within the deadline, the Ministry completes the review of the case and rejects the request.</p>	<p>predlozheni projekat treba da podleze procedurama koje treba da se dobiju ekološkog saglasnost. U izuzetnim slučajevima koji se odnose na prirodu, složenost, lokaciju ili veličinu projekta, Komisija za PUŽS može produžiti rok i pismeno obavestiti podnosioca prijave o razlozima odlaganja i datumu na koji se očekuje utvrđivanje. Ovo produženje roka ne može biti duže od 90 dana.</p> <p>7. Odluka o izboru objavljuje na oglasnu tablu opštine, uključujući službenu internet stranicu Ministarstva, ili na drugom odgovarajućem obrascu, pet (5) dana od dana donošenja odluke. Odluka se u istom roku objavljuje na sajtu Ministarstva.</p> <p>8. Ukoliko dokumentacija priložena uz prijavu nije kompletna, Ministarstvo traži dodatne informacije i dokumentaciju od podnosioca zahteva i određuje razuman rok za njihovo podnošenje. ali ne duže od 30 dana. Ako dokumenti i informacije ne budu dostavljeni u roku, Ministarstvo završava razmatranje predmeta odbija zahtev.</p>
--	---	--

<p>9. Nëse, në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni nuk kërkohet raporti i VNM-së, komuna përkatëse mund të fillojë procedurën për dhënien e lejes mjedisore komunale edhe për projektet të cilat nuk përfshihen në listën e aktiviteteve që i nënshtrohen lejes mjedisore komunale sipas Shtojcës së Udhëzimit Administrativ përkatës për Leje Mjedisore Komunale.</p>	<p>9. If, in accordance with paragraph 2 of this Article, an EIA report is not required, the designated municipality may initiate the procedure for issuing a municipal environmental permit also for projects which are not included in the list of activities that are subject to the municipal environmental permit, according to the Annex of the relevant Administrative Instruction for Municipal Environmental Permit.</p>	<p>9. Ako, u skladu sa stavom 2. ovog člana, nije potreban izveštaj PUŽS određena opština može pokrenuti postupak za izdavanje opštinske ekološke dozvole. takođe za projekte koji nisu uključeni u spisak aktivnosti koje podležu opštinskoj ekološkoj dozvoli prema dodatku relevantnog Administrativnog Uputstva za Opštinsku Ekološku Dozvolu.</p>
<p>Neni 11 Raporti i VNM- së</p>	<p>Article 11 EIA report</p>	<p>Član 11 Izveštaj PUŽS</p>
<p>1. Raporti i VNM-së përmban:</p> <p>1.1. Përshkrimin e projektit duke përfshirë informata të përcaktuara në Shtojcën 4 të këtij ligji mbi vendin, dizajnin, madhësinë dhe veçori të tjera përkatëse të projektit;</p> <p>1.2. Përshkrimin e pasojave të projektit në mjedis;</p> <p>1.3. Përshkrimin e veçorive të projektit dhe masat e parapara për të shmangur, parandaluar apo zvogëluar dhe mënjanuar pasojat negative mjedisore;</p> <p>1.4. Përshkrimin e alternativave të arsyeshme të studiuara nga aplikuesi që</p>	<p>1. The EIA report contains:</p> <p>1.1. Project description including location information defined in Annex 4 of this law project design, size and other relevant project features;</p> <p>1.2. Description of the project consequences on the environment;</p> <p>1.3. A description of the features of the project and the measures envisaged to avoid, prevent or reduce and also to eliminate the negative environmental consequences;</p> <p>1.4. A description of the reasonable alternatives studied by the applicant,</p>	<p>1. Izveštaj PUŽS sadrži:</p> <p>1.1. Opis projekta, uključujući informacije definisane u Prilogu 4 ovog zakona o lokaciji, dizajn, veličinu i druge relevantne karakteristike projekta;</p> <p>1.2. Opis posledica projekta na životnu sredinu;</p> <p>1.3. Opis karakteristika projekta i predviđenih mera za izbegavanje, sprečavanje ili smanjenje i otklanjanje negativnih posledica po životnu sredinu;</p> <p>1.4. Opis razumnih alternativa koje je podnosilac predstavke proučio, a koje su</p>

<p>janë relevante për projektin dhe veçoritë e tij specifike si dhe përshkrimin e arsyeve kryesore për opsionin e zgjedhur duke marrë parasysh pasojat mjedisore të projektit;</p> <p>1.5. Përmbledhjen jo-teknike të informatave të përcaktuara në paragrafët 1.1 deri 1.4 të këtij neni;</p> <p>1.6. Informata shtesë të përcaktuara në Shtojcën 4 të këtij ligji për veçoritë specifike të projektit të caktuar apo një lloji të caktuar projektesh apo për veçoritë mjedisore që ka gjasa të preken.</p> <p>1.7. Nëse jepet mendimi sipas paragrafit 2 të këtij neni VNM-ja do të bazohet në atë mendim dhe të përfshijë informatat që mund të kërkohen për arritjen e përfundimit mbi efektet mjedisore të projektit duke marrë parasysh njohuritë dhe metodat vlerësuese aktuale.</p> <p>1.8. Gjatë përgatitjes së raportit të VNM-së me qëllim të shmangies së përsëritjes së vlerësimeve aplikuesi duhet të marrë parasysh rezultatet e disponueshme të vlerësimeve të tjera përkatëse sipas legjisllacionit në fuqi.</p>	<p>which are relevant to the project and its specific features, as well as a description of the main reasons for the selected option, taking into account the environmental consequences of the project;</p> <p>1.5. Non-technical summary of the information referred to in paragraphs 1.1 to 1.4 of this Article;</p> <p>1.6. Additional information defined in Annex 4 of this law, for the specific features of a certain project, or a certain type of projects, or for the environmental features that are likely to be affected.</p> <p>1.7. If an opinion is given under paragraph 2 of this Article, the EIA shall be based on that opinion and include the information that may be required to reach a conclusion on the environmental effects of the project, taking into account current knowledge and assessment methods.</p> <p>1.8. When preparing the EIA report, in order to avoid duplication of assessments, the applicant should take into account the available results of other relevant assessments according to applicable law.</p>	<p>relevantne za projekat i njegove posebne karakteristike, kao i opis glavnih razloga za odabranu opciju uzimajući u obzir ekološke posledice projekta;</p> <p>1.5. Netehnički rezime informacija navedenih u stavovima 1.1 do 1.4 ovog člana;</p> <p>1.6. Dodatne informacije navedene u Aneksu 4 ovog zakona, za specifične karakteristike određenog projekta ili određene vrste projekta ili za karakteristike životne sredine na koje bi moglo dotiče.</p> <p>1.7. Ako se daje mišljenje prema stavu 2. ovog člana, PUŽS će se zasnivati na tom mišljenju i uključivati informacije koje mogu biti potrebne za donošenje zaključka o uticaju projekta na životnu sredinu uzimajući u obzir trenutno znanje i metode procene.</p> <p>1.8. Prilikom pripreme izveštaja o PUŽS, kako bi se izbeglo ponavljanje ocena, podnosilac zahteva treba da uzme u obzir dostupne rezultate drugih relevantnih procena prema važećem zakonu.</p>
---	---	--

<p>2. Komisioni i VNM-së duke marrë për bazë informatat e ofruara nga aplikuesi, në veçanti mbi veçoritë specifike të projektit, duke përfshirë vendndodhjen dhe kapacitetin teknik si dhe ndikimin e mundshëm në mjedis, do të konsultojë institucionet që kanë gjasa të ndikohen nga projekti gjithashtu mund t'u kërkojnë këtyre institucioneve për të dhënë mendim.</p> <p>3. Mendimi i dhënë nga institucionet që kanë gjasa të ndikohen nga projekti është pjesë përbërëse e raportit të VNM-së.</p> <p>4. Për të siguruar se raporti i VNM- së është i plotë dhe cilësor:</p> <p>4.1. Aplikuesi garanton që raporti i VNM-së të përgatitet nga eksperti mjedisor;</p> <p>4.2. Komisioni i VNM-së garanton që posedon aftësi profesionale të mjaftueshme për të ekzaminuar raportin e VNM-së;</p> <p>4.3. Komisioni i VNM-së mund të kërkojë opinion nga eksperti ose Institucion ndërkombëtar për disa aspekte të VNM-së;</p> <p>4.4. Komisioni VNM-së sipas nevojës, kërkon nga aplikuesi informata shtesë në</p>	<p>2. The EIA Commission, taking into account the information provided by the applicant, in particular on the specific features of the project, including the location and technical capacity, as well as the possible impact on the environment, will consult with the institutions most likely to be affected by the project, and may also ask the host institutions for their opinion.</p> <p>3. The opinion given by the institutions likely to be influenced by the project is an integral part of the EIA report.</p> <p>4. To ensure that the EIA report is complete and qualitative:</p> <p>4.1. The applicant ensures that the EIA report is prepared by environmental experts;</p> <p>4.2. The EIA commission ensures that it possesses sufficient professional skills to examine the EIA report.</p> <p>4.3. The EIA commission can request an opinion by international expert or institution on some aspects of the EIA;</p> <p>4.4. The EIA commission, as needed, requests from the applicant additional</p>	<p>2. Komisija za PUŽS, uzimajući u obzir informacije koje je podneo podnosilac prijave, posebno o posebnim karakteristikama projekta, uključujući lokaciju i tehničke kapacitete, kao i mogući uticaj na životnu sredinu, će se konsultovati sa institucijama na koje će projekat najverovatnije uticati, a takođe može zatražiti mišljenje i od drugim institucijama.</p> <p>3. Mišljenje institucija na koje bi projekat mogao uticati je sastavni deo PUŽS izveštaja</p> <p>4. Da biste bili sigurni da je izveštaj PUŽS potpun i kvalitetan:</p> <p>4.1. Podnosilac zahteva osigurava da izveštaj o PUŽS se priprema stručnjak za životnu sredinu;</p> <p>4.2. Komisija za PUŽS osigurava da poseduje dovoljno profesionalnih veština za ispitivanje izveštaja o PUŽS;</p> <p>4.3. Komisija za PUŽS može tražiti mišljenje stručnjaka ili međunarodne institucije o određenim aspektima PUŽS.</p> <p>4.4. Komisija za PUŽS, prema potrebi, zahteva od podnosioca zahteva dodatne</p>
---	--	---

<p>përputhje me Shtojcën 4 të këtij ligji, që janë të rëndësishme për arritjen e përfundimit mbi efektet mjedisore të projektit.</p> <p>5. Për të siguruar cilësinë e raportit Ministria harton një udhëzues/manual për përmbajtjen, metodologjinë dhe përputhshmërinë e raportit me kërkesat ligjore, praktikat e zbatueshme dhe aspektet e tjera teknike të raportit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 12 Hartuesi i raportit të VNM-së</p> <p>1. Raporti i VNM-së hartohet nga personi fizik i pajisur me licencë apo personi juridik i licencuar nga Ministria.</p> <p>2. Vlefshmëria e licencimit nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) vjet.</p> <p>3. Ministria revokon licencën në rast të konstatimit se i licencuari nuk përmbush cilësinë e raporteve të VNM-së.</p> <p>4. Ministria me akt nënligjor përcakton procedurat dhe kriteret për licencimin e personave fizik dhe juridik për hartimin e raportit të VNM-së.</p>	<p>information in accordance with Annex 4 of this law, which are important for reaching a conclusion on the environmental effects of the project; and</p> <p>5. To ensure the quality of the report, the Ministry drafts a guide/manual on the content, methodology and compliance of the report with legal requirements, applicable practices and other technical aspects of the report.</p> <p style="text-align: center;">Article 12 Compiler of the EIA report</p> <p>1. The EIA report is drawn up by a natural person equipped with a license or a legal person licensed by the Ministry.</p> <p>2. The validity of the license from paragraph 1 of this article is three (3) years.</p> <p>3. The Ministry revokes the license in case of finding that the licensee does not meet the quality of the EIA reports.</p> <p>4. The Ministry by sub-legal act determines the procedures and criteria for the licensing of natural and legal persons, for the drafting of the EIA report.</p>	<p>informacije u skladu sa Aneksom 4 ovog zakona, koje su važne za konačnog postizanje o uticaju projekta na životnu sredinu.</p> <p>5. Kako bi se osigurao kvalitet izveštaja, Ministarstvo izrađuje vodič/priručnik o sadržaju, metodologiji i usklađenosti izveštaja sa zakonskim zahtevima, primenljivom praksom i drugim tehničkim aspektima izveštaja</p> <p style="text-align: center;">Član 12 Nacrt izveštaja PUŽS</p> <p>1. PUŽS izveštaj sastavlja od strane fizičko lice premljen licencom ili pravo lice licencirano od strane Ministarstva.</p> <p>2. Važnosti licen iz stav 1 ovog člana je (3) godine.</p> <p>3. Ministrastvo poništi licene u slučaju o kom slučaju konstantuje da se licencirano lice ne ispunjava kvaltit izveštaja za PUŽS.</p> <p>4. Ministrastvo podzakonskim aktimima utvrđuje procedure i kriterijume za licenciranje fizičko I pravno lice za izrdau PUŽS izveštaj.</p>
---	---	--

<p>5. Emrin, mbiemri dhe nënshkrimi i hartuesit dhe aplikuesit paraqiten në Raportin e VNM.</p> <p>6.Hartuesi i raportit të VNM-së dhe operatori është përgjegjës për saktësinë e të gjitha informatave dhe të dhënave të përfshira në raportin e VNM-së.</p> <p style="text-align: center;">Neni 13 Dorëzimi i raportit të VNM-së</p> <p>1. Aplikuesi duhet t'i dorëzoj katër (4) kopje të raportit të VMN-së në formë të shkruar dhe një (1) kopje në formë elektronike në Ministri.</p> <p>2. Raportit të VNM-së aplikuesi ia bashkëngjet:</p> <p>2.1. Dëshminë e pagesës për aplikim për pëlqim mjedisor;</p> <p>2.2. Certifikatën e regjistrimit të biznesit;</p> <p>2.3. Fleta poseduese (certifikata mbi të drejtën e pronësisë);</p> <p>2.4. Kopjen e planit me koordinata;</p> <p>2.5. Planin e situacionit;</p>	<p>5.The EIA report contain the name, surname and signature of the drafter and the applicant.</p> <p>6.The drafter of the EIA report and the operator are responsible for the accuracy of all information and data included in the EIA report.</p> <p style="text-align: center;">Article 13 Submission of EIA report</p> <p>1. The applicant must submit to the Ministry four (4) copies of the EIA report in written form and one (1) copy in electronic form.</p> <p>2. Upon submission of the EIA report, the applicant submits:</p> <p>2.1. Proof of payment for application for environmental consent;</p> <p>2.2. Business registration certificate;</p> <p>2.3. Possession list (certificate of ownership);</p> <p>2.4. Copy of plan with coordinates;</p> <p>2.5. Situation plan;</p>	<p>5.Izveštaj o PUŽS sadrži ime, prezime i potpis izrađivača i podnosioca zahteva.</p> <p>6.Izrađivač izveštaja o PUŽS i operater odgovorni su za tačnost svih informacija i podataka uključenih u izveštaj PUŽS-a.</p> <p style="text-align: center;">Član 13 Dostavljanje PUŽS izveštaja</p> <p>1. Podnosilac zahteva mora da dostavi četiri (4) primerka PUŽS izveštaja u pisanoj formi i jednu (1) kopiju u elektronskom obliku Ministarstvu.</p> <p>2. Nakon podnošenja izveštaja o PUŽS, podnosilac zahteva podnosi:</p> <p>2.1. Dokaz o uplati za zahtev za dobijanje ekološke saglasnosti;</p> <p>2.2.Potvrda o registraciji preduzeća;</p> <p>2.3. Posedovni list (potvrda o pravu vlasništvu);</p> <p>2.4. Kopija plana sa koordinatama;</p> <p>2.5. Plan situacije;</p>
---	--	--

<p>2.6. Kontratën për shfrytëzimin e ngastrës ose objektit, për rastet kur ngastra ose objekti nuk është pronë e aplikuesit;</p> <p>2.7. Në rastet e objekteve për lëndë djegëse të lëngëta apo materie eksplozive, duhet pëlqimi nga autoritetet kompetente për lejimin e vendosjes së rezervuarëve;</p> <p>2.8. Pëlqimin e Komunës për ushtrimin e veprimtarisë ose njoftim-informimi sipas Planit Zhvillimor Komunal, hartat zonale, kushtet ndërtimore.</p> <p>3. Aplikuesi ofron një (1) kopje fizike apo elektronike të raportit të VNM-së për Komunën në të cilën planifikohet të realizohet projekti i cili duhet të jetë në dispozicion të publikut.</p> <p style="text-align: center;">Neni 14 Shqyrtimi i raportit të VNM-së</p> <p>1. Në afat prej pesë (5) ditësh nga pranimi i raportit të VNM-së, tri (3) kopje të raportit të VMN-së në formë të shkruar dhe një (1) kopje në formë elektronike i dërgohen Komisionit të VNM-së.</p>	<p>2.6. The contract for the use of the parcel or building, in cases when the parcel or building is not the property of the applicant;</p> <p>2.7. In cases of facilities for liquid fuels or explosives, there must be a consent by the competent authorities for permitting the placement of tanks;</p> <p>2.8. Consent of the Municipality for exercising the activity, or notification-information according to the Municipal Development Plan, zoning map, construction conditions.</p> <p>3. The applicant provides one (1) physical or electronic copy of the EIA report to the Municipality, in which the project is planned to be implemented, and which should be available to the public</p> <p style="text-align: center;">Article 14 Review of the EIA report</p> <p>1. Within five (5) days from the receipt of the EIA report, three (3) copies of the EIA report in written form and one (1) copy in electronic, form shall be sent to the EIA Commission.</p>	<p>2.6. Ugovor o korišćenju parcele ili zgrade, u slučajevima kada parcela ili zgrada nisu vlasništvo podnosioca zahteva;</p> <p>2.7. U slučaju objekata za tečna goriva ili eksplozive: Saglasnost nadležnih organa da se dozvoli postavljanje rezervoara;</p> <p>2.8. Saglasnost Opštine za obavljanje delatnosti ili obaveštenja-informacije prema Opštinskom razvojnom planu, zonska karta, građevinske uslove.</p> <p>3. Podnosilac zahteva dostavlja jednu (1) fizičku ili elektronsku kopiju PUŽS Opštini u kojoj se planira implementacija projekta, a koja bi trebala biti dostupna javnosti.</p> <p style="text-align: center;">Član 14 Pregled izveštaja PUŽS</p> <p>1. U roku od pet (5) dana od prijema izveštaja o PUŽS, tri (3) kopije izveštaja o PUŽS u pisanoj formi i jedna (1) kopija u elektronskom obliku biće poslate Komisiji za PUŽS.</p>
--	--	--

<p>2. Komisioni i VNM-së shqyrton informacionin e paraqitur në raportin e VNM-së dhe çdo informacion plotësues të dhënë, kur është e nevojshme, nga aplikuesi, dhe çdo informacion relevant të marrë nëpërmjet konsultimeve me publikun dhe autoritetet përkatëse.</p> <p>3. Komisioni i VNM-së shqyrton raportin duke u bazuar në kriteret vijuese:</p> <p>3.1. Saktësinë e përshkrimit të projektit përfshirë zgjidhjet alternative ashtu siç kërkohen;</p> <p>3.2. Saktësinë e identifikimit dhe VNM;</p> <p>3.3. Përshtatshmërinë e masave të ndërmarra për zbutjen e ndikimeve negative, përfshirë rehabilitimin e zonave të ndikuara nga eksploatimi i resurseve natyrore, aktivitetet për menaxhimin e mbeturinave apo ndonjë aktiviteti të ngjashëm;</p> <p>3.4. Përshtatshmërinë e skemave të propozuara monitoruese;</p> <p>3.5. Kriteret të tjera që konsiderohen të rëndësishëm për rrethana të veçanta.</p> <p>3.6. Aty ku është e nevojshme edhe shqyrtimin e tij plotësues.</p>	<p>2. The EIA Commission examines the information presented in the EIA report and any supplementary information provided, where necessary, by the applicant, and any relevant information received through the consultations with the public and the authorities concerned.</p> <p>3. The EIA Commission reviews the report based on the following criteria:</p> <p>3.1. The accuracy of the project description including alternative solutions as required;</p> <p>3.2. Accuracy of identification and EIA;</p> <p>3.3. The adequacy of the measures taken to mitigate the negative impacts, including the rehabilitation of areas affected by the exploitation of natural resources, waste management activities, or any similar activity;</p> <p>3.4. The adequacy of the proposed monitoring schemes;</p> <p>3.5. Other criteria, which are considered to be relevant for special circumstances.</p> <p>3.6. Where appropriate, its own supplementary examination</p>	<p>2. Komisija za PUŽS pregledaće informacije date u izveštaju o PUŽS i sve dodatne informacije koje je podnosilac zahteva dao, gde je to potrebno, kao i sve relevantne informacije dobijene konsultacijom sa javnošću i relevantnim organima.</p> <p>3. Komisija za PUŽS pregleda izveštaj na osnovu sledećih kriterijuma:</p> <p>3.1. Tačnost opisa projekta uključujući alternativna rešenja prema potrebi;</p> <p>3.2. Tačnost identifikacije i PUŽS;</p> <p>3.3. Adekvatnost preduzetih mera za ublažavanje negativnih uticaja, uključujući rehabilitaciju područja pogođenih eksploatacijom prirodnih resursa, aktivnostima upravljanja otpadom ili bilo kojim sličnim aktivnostima;</p> <p>3.4. Adekvatnost predloženih šema praćenja;</p> <p>3.5. Drugi kriterijumi za koje se smatra da su relevantni za određene okolnosti.</p> <p>3.6. Pri čemu je neophodno i njeno dodatno razmatranje</p>
--	--	--

<p>4. Gjatë shqyrtimit të raporteve të VNM- së për projektet specifike, Komisioni i VNM- së kërkon informata nga institucionet përgjegjëse për të dhënat të cilat janë të nevojshme për shqyrtim.</p> <p>5. Komisioni i VNM-së harton propozim-vendimin pasi të ketë shqyrtuar dokumentacionin përcjellës, raportin e VNM-së, duke marrë parasysh rezultatet e konsultimeve, dhe aty ku është e përshtatshme, dokumentacionin plotësues.</p> <p style="text-align: center;">Neni 15 Shqyrtimi i raporti të VNM-së nga ekspertët e jashtëm</p> <p>1. Për shqyrtimin e raportit të VNM, Ministria sipas nevojës mund të kontraktojë ekspertë vendorë ose ndërkombëtarë, të cilët kanë përvojë të dëshmuar në VNM me kualifikimet minimale të mëposhtme:</p> <p>1.1. Kualifikim i lartë universitar i shkencave teknike ose natyrore dhe fushave përkatëse, dhe</p> <p>1.2. Së paku pesë (5) vjet përvojë profesionale dhe hulumtuese në fushën e mbrojtjes së mjedisit.</p> <p>2. Ekspertët e jashtëm paraqesin mendimet e tyre me shkrim të cilat i dorëzohen</p>	<p>4. During the review of EIA reports for specific projects, the EIA Commission requests information from the responsible institutions for the data which are necessary for review.</p> <p>5. The EIA Commission, after reviewing the accompanying documentation, the EIA report, taking into account the results of the consultations, and where appropriate, its own supplementary documentation drafts a Proposal-Decision.</p> <p style="text-align: center;">Article 15 Review of the EIA report by external experts</p> <p>1. For the review of the EIA report, the Ministry may, if necessary, contract external national or international experts who have proven experience in EIA with the minimum qualifications:</p> <p>1.1. A higher university qualification of technical or natural sciences and related fields, and</p> <p>1.2. At least five (5) years of professional expertise and research expertise in the field of environmental protection.</p> <p>2. External experts submit their opinions in writing, which are submitted to the</p>	<p>4. Tokom pregleda izveštaja o PUŽS za posebne projekte, Komisija za PUŽS zahteva informacije od odgovornih institucija za podatke koji su neophodni za pregled.</p> <p>5. Komisija za PUŽS, nakon pregleda prateće dokumentacije, izveštaj PUŽS, uzimajući u obzir rezultate konsultacija, i po potrebi, dopunsku dokumentaciju izrađuje predlog-Odluku.</p> <p style="text-align: center;">Član 15 Razmatranje izveštaja PUŽS od strane spoljnih stručnjak</p> <p>1. Za razmatranje izveštaja o PUŽS, Ministarstvo može, ako je potrebno, angažovati spoljne stručnjake koji imaju dokazano iskustvo u PUŽS sa sledećim minimalnim kvalifikacijama kao:</p> <p>1.1. Viša univerzitetska kvalifikacija tehničkih ili prirodnih nauka i srodnih oblasti, i</p> <p>1.2. Najmanje pet (5) godina stručnog i istraživačkog iskustva u oblasti zaštite životne sredine.</p> <p>2. Spoljni stručnjaci dostavljaju svoja mišljenja u pisanoj formi, koja se</p>
--	---	---

<p>Ministrisë me afatin e caktuar prej tridhjetë (30) ditësh.</p> <p>3. Ekspertët e jashtëm të përfshirë në hartimin e një raportit të VNM-së nuk mund të marrin pjesë edhe në shqyrtimin e të njëjtit raport.</p> <p>4. Raporti dërgohet për komente dhe kontrollin e vlefshmërinë e të dhënave në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe Autoritetin Rajonal të Pellgjeve Lumore. Nëse jepet mendim negativ, atëherë raporti duhet të rishikohet dhe të plotësohet në bazë të komenteve të tyre. Në rast të mendimit të dytë negativ, procesi i VNM-së ndërpritet dhe kërkesa refuzohet.</p> <p style="text-align: center;">Neni 16 Informimi i publikut dhe pjesëmarrja në debat për raportin e VNM-së</p> <p>1. Ministria siguron që publiku të jetë i informuar për projektin specifik, duke përfshirë informacionet rreth procedurave të shqyrtimit deri në vendimmarrje, informacionet se ku dhe kur duhet të dërgohen komentet dhe pyetje në lidhje me projektin, detajet e autoritetit kompetent për vendimmarrje, dhe informacionet mbi raportin e VNM përmes shpalljes publike dhe nëpërmjet mjeteve elektronike të</p>	<p>Ministry, within the deadline set by the Ministry within a period of thirty (30) days.</p> <p>3. External experts involved in drafting an EIA report, may not provide opinion for the review of the same report.</p> <p>4. The report is sent for comments and control of data validity to the Kosovo Environmental Protection Agency and to the Regional River Basin Authority. If negative opinion is issued, then the report must be revised and supplemented based on their comments. In case of second negative opinion the EIA process is stopped and the request rejected.</p> <p style="text-align: center;">Article 16 Public information and participation in the debate on the EIA report</p> <p>1. The Ministry ensures that the public is informed about the specific project, including information about the review procedures until decision-making, information about where and when to send comments and questions about the project, details of the competent decision-making authority, and information about the report of EIA through public announcement, as well as through electronic tools of</p>	<p>dostavljaju Ministarstvu, u roku koji odredi Ministarstvo, u roku od trideset (30) dana.</p> <p>3. Spoljni stručnjaci uključeni u izradu izveštaja o PUŽS ne mogu učestvovati u pregledu istog izveštaja.</p> <p>4. Izveštaj se šalje na komentare i kontrolu valjanosti podataka Kosovskoj Agenciji za Zaštitu Zivotne sredine i Regionalnoj Upravi za Riječne Slivove. Ako se izda negativni opinion, onda se izveštaj mora revidirati i dopuniti na osnovu njihovih komentara. U slučaju drugog negativnog opinionona, proces PUŽS se zaustavlja i zahtev se odbija.</p> <p style="text-align: center;">Član 16 Informisanje javnosti i učešće u raspravi o PUŽS izveštaju</p> <p>1. Ministarstvo obezbeđuje da javnosti bude informisan o konkretnom projektu, uključujući informacije o postupcima revizije do donošenja odluke, informacije o tome gde i kada treba poslati komentare i pitanjau vezi sa projektom podatke o nadležnom organu za odlučivanje i podatke o izveštaj PUŽS putem javnog oglasa i putem elektronskih sredstava informisanja. Informacije o izveštaju o postupku PUŽS i</p>
---	--	--

<p>informacionit. Informacioni mbi Raportin e procedurave të VNM-së dhe draft-raporti i VNM-së publikohen në uebfaqen e Ministrisë. Ky informacion publikohet pesë (5) ditë nga data e marrjes së raportit të VNM-së për projektin.</p> <p>2. Publikut të interesuar do t'i jepet mundësia në fazë të hershme për të marrë pjesë në të gjitha fazat e procedurës së VNM-së Afati kohor për konsultimin publik për raportin e VNM-së nuk mund të jetë më i shkurtër se tridhjetë (30) ditë nga data e publikimit të informacionit në lidhje me raportin e VNM-së dhe dëgjimit publik në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni.</p> <p>3. Raporti i VNM-së i nënshtrohet debatit publik.</p> <p>4. Plani dhe organizimi i debatit është përgjegjësi e aplikuesit i cili do të:</p> <p>4.1. Përgatitë njoftimin duke përfshirë shpërndarjen e informacionit në formë elektronike, lokacionin e mbajtjes së debatit publik si dhe përmbledhjen jo-tekniqe të raportit të VNM-së;</p> <p>4.2. Informojë publikun përmes mjeteve të informimit, ku përfshihet shpallja më</p>	<p>information. Information on the EIA procedure report and the draft EIA report are always published on the Ministry's website. This information is published five (5) days since the date of receipt of the EIA report for the project.</p> <p>2.The interested public will be given the opportunity at an early stage to participate in all stages of the EIA procedure, including the decision-making process. The time frame for consulting the public concern on the EIA report may not be shorter than thirty (30) days from the date of publishing information concerning the EIA report and the public hearing in accordance with paragraph 4 of this article.</p> <p>3.The EIA report is subject to the public debate.</p> <p>4.The planning and organization of the debate is the responsibility of the applicant who will:</p> <p>4.1. Prepare information including electronically dissemination, the location of the public debate as well as the non-technical summary of the EIA report;</p> <p>4.2. Inform the public, through the media, including the publication in at</p>	<p>nacrt izveštaja o proceni uticaja na životnu sredinu se uvek objavljuju na internet stranici Ministarstva. Ove informacije se objavljuju pet (5) dana od datuma prijema izveštaja PUŽS za projekat.</p> <p>2. Zainteresovanoj javnosti biće pružena prilika da u ranoj fazi učestvuje u svim fazama postupka PUŽS, uključujući i proces donošenja odluka. Rok za javnu raspravu o PUŽS izveštaju ne može biti kraći od trideset (30) dana od datuma objavljivanja informacije u vezi sa izveštajem o PUŽS i javnoj raspravi u skladu sa stavom 4 ovog člana.</p> <p>3. Izveštaj PUŽS je predmet javne rasprave.</p> <p>4. Za planiranje i organizaciju rasprave odgovoran je podnosilac zahtev a koji će:</p> <p>4.1. Priprema obaveštenje koje uključuje informisanje u elektronskoj formi, lokaciju javne rasprave kao i netehnički sažetak izveštaja o proceni uticaja na životnu sredinu.</p> <p>4.2. Obavesti javnost, putem medija, uključujući objavljivanje u najmanje</p>
---	--	---

<p>së paku në një (1) gazetë ditore, në uebfaqen e Ministrisë dhe në faqen e Komunës ku zbatohet projekti, për datën, lokacionin dhe kohën e mbajtjes së debatit publik;</p> <p>4.3. Vendoset kopja e njoftimit në tabelën e shpalljeve të Komunës në të cilën realizohet projekti, për mbajtjen e debatit publik.</p> <p>5. Aplikuesi i dëshmon Ministrisë përmbushjen e kërkesave nga paragrafi 4 i këtij neni.</p> <p>6. Debatit publik nuk mbahet përderisa aplikuesi nuk ka marrë konfirmimin e Ministrisë me shkrim se të gjitha obligimet sipas paragrafit 4 të këtij neni janë plotësuar.</p> <p>7. Ministria përgatitë njoftimin për debat publik dhe cakton datën dhe kohën e mbajtjes së debatit publik pas konfirmimit nga ana e aplikuesit.</p> <p>8. Aplikuesi informon Ministrinë në afatin prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga dita e pranimit të njoftimit. Nëse operatori nuk vepron sipas kërkesave të këtij paragrafi Ministria ndërpret procedurën e shqyrtimit.</p>	<p>least one (1) daily newspaper, at the Ministry webpage, and on the webpage of the Municipality where the project is implemented, of the date, location and held time of the public debate.</p> <p>4.3. A copy of the notice for the holding of the public debate shall be placed on the bulletin board of the Municipality in which the project is carried out;</p> <p>5. The applicant proves to the Ministry that he has fulfilled the requirements from paragraph 4 of this article.</p> <p>6. The public debate is not held until the applicant has received written confirmation from the Ministry that all obligations according to paragraph 4 of this article have been fulfilled.</p> <p>7. The Ministry prepares the notice for public debate and sets the date and time of holding the public debate, after confirmation by the applicant.</p> <p>8. The applicant informs the Ministry within thirty (30) calendar days from the day of receiving the notification. If the operator does not act according to the requirements of this paragraph, the Ministry stops the examination procedure.</p>	<p>jednom (1) dnevnom listu, na internet stranici Ministarstva i na veb stranici Opštine u kojoj se projekat realizuje, o datumu, mestu i vremenu održavanje javne rasprave;</p> <p>4.3. Stavlja na oglasnu tablu Opštine u kojoj se realizuje projekat kopiju obaveštenja za održavanje javne rasprave.</p> <p>5. Podnosilac prijave dokazuje u Ministarstvo ispunjavanje zahteva od stav 4 ovog zakona</p> <p>6 Javna rasprava se ne održava dok podnosilac zahteva ne dobije pismenu potvrdu Ministarstva da su ispunjene sve obaveze prema stavu 4 ovog člana .</p> <p>7. Ministarstvo priprema obaveštenje za javnu raspravu i utvrđuje datum i vreme održavanja javne rasprave nakon potvrde podnosioca zahteva.</p> <p>8. Podnosilac zahteva je dužan da obavesti Ministarstvo u roku od trideset (30) dana od dana prijema obaveštenja. Ako operater ne postupi u skladu sa uslovima iz ovog stava, Ministarstvo obustavlja postupak revizije.</p>
--	--	--

<p>9.Krahas debatit publik, Ministria në platformën e saj e vendos raportin e VNM-së për konsultim publik, sipas Rregullores përkatëse për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik.</p>	<p>9. In addition to the public debate, the Ministry puts the EIA report on its platform for public consultation, according to the relevant Regulation on Minimum Standards for the Public Consultation Process.</p>	<p>9. Pored javne rasprave, Ministarstvo postavlja Izveštaj PUS-a na platformu za javne konsultacije u skladu sa Uredbom o minimalnim standardima u postupku javnih konsultacija.</p>
<p>10. Debatit publik konsiderohet i dështuar, nëse në kohën e mbajtjes së debatit publik nuk është prezent hartuesi i raportit të VNM-së dhe aplikuesi. Aplikuesi është i detyruar që në afat prej dhjetë (10) ditëve të bëjë kërkesë në Ministri për rishpalljen e debatit publik. Në rast të dështimit të sërishëm të debatit publik për shkak të mungesës së hartuesit të VNM-së dhe aplikuesit, aplikuesi detyrohet të aplikoj për pëlqim mjedisor.</p>	<p>10. The public debate is considered failed, if the drafter of the EIA report and the applicant are not present at the time of the public debate. The applicant is obliged to submit a request to the Ministry for the re-announcement of the public debate within ten (10) days. In case of repeated failure of the public debate due to the absence of the drafter of the EIA and the applicant, the applicant is forced to apply for environmental consent.</p>	<p>10. Javna rasprava se smatra neuspešnom, ako sastavljač izveštaja o proceni uticaja na životnu sredinu i podnosilac prijave nisu prisutni u vreme javne rasprave. Podnosilac zahteva je dužan da u roku od deset (10) dana podnese zahtev Ministarstvu za ponovno raspisivanje javne rasprave. U slučaju ponovljenog neuspjeha javne rasprave zbog odsustva izrađivača PUŽS i podnosioca zahtjeva, podnosilac zahteva je prinuđen da podnese zahtev za dobijanje ekološke saglasnosti.</p>
<p>11. Debatit publik mbahet në afat prej njëzet (20) deri njëzet e pesë (25) ditësh pas informimit të autoriteteve mjedisore dhe publikut të interesuar në përputhje me këtë nen.</p>	<p>11. The public debate is held within twenty (20) to twenty-five (25) days after informing the environmental authorities and the interested public in accordance with this article.</p>	<p>11. Javna rasprava se održava u roku od dvadeset (20) do dvadesetpet (25) dana nakon obavještanja organa za zaštitu životne sredine i zainteresovane javnosti u skladu sa ovim članom.</p>
<p>12. Të gjitha pyetjeve dhe komenteve të publikut duhet t'u jepet përgjigje nga aplikuesi përpara se të përgatitet Propozim Vendimi për VNM.</p>	<p>12. All public questions and comments must be answered by the applicant, before the EIA Decision Proposal is prepared.</p>	<p>12. Na sva pitanja i komentare javnosti podnosilac zahteva mora odgovoriti pre nego što se može pripremiti predlog-oduluke o proceni uticaja na životnu sredinu.</p>
<p>13. Debatit publik mbahet në prezencë fizike dhe në formë virtuale.</p>	<p>13. The public debate is held in physical presence and in virtual form.</p>	<p>13. Javne rasprave se održavaju fizički ali i u virtuelnom obliku.</p>

<p>14. Ministria shqyrton vërejtjet dhe merr në konsideratë komentet e dala nga debati publik si dhe përgjigjet e dhëna nga hartuesi gjatë përgatitjes së Propozim Vendimit për pëlqimin mjedisor.</p> <p style="text-align: center;">Neni 17 Rezultati i shqyrtimit të dokumentacionit përcjellës dhe raportit të VNM-së</p> <p>1. Komisioni i VNM-së në afat prej njëzet (20) ditësh nga dita e mbajtjes së debatit publik, shqyrton vërejtjet dhe mendimet e dala nga debati publik, si dhe përgjigjet e dhëna nga hartuesi.</p> <p>2. Komisioni i VNM-së mund të kërkoj plotësimin e dokumentacionit nga aplikuesi, të ndryshoj ose të plotësoj elemente të caktuara të raportit të VNM-së, i cili është dorëzuar.</p> <p>3. Aplikuesi plotëson e dokumentacionin brenda tridhjetë (30) ditësh ndërsa ndryshimet e kërkuara në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni i realizon në afat prej dhjetë (10) ditësh dhe i dorëzon Ministrisë raportin e VNM-së të ndryshuar dhe të kompletuar.</p>	<p>14. The Ministry examines the remarks and takes into consideration the comments from the public debate, as well as the answers given by the drafter during the preparation of the Proposed Decision for the environmental consent.</p> <p style="text-align: center;">Article 17 The result of reviewing the accompanying documentation and the EIA report</p> <p>1. The EIA Commission within twenty (20) days from the day of holding the public debate, reviews the remarks and opinions arising from the public debate, as well as responses provided by the drafter.</p> <p>2. The EIA Commission may ask the applicant to complete the documentation, to change or complete certain elements of the EIA report, which has been submitted.</p> <p>3. The applicant must complete the documentation within thirty (30) days, whereas the required changes in accordance with paragraph 2 of this Article, must be made within ten (10) days, and submit to the Ministry the EIA report, amended and completed.</p>	<p>14. Ministarstvo razmatra primedbe i uzima u obzir komentare koji proizilaze iz javne rasprave, kao i odgovore datih od strane predlagača prilikom izrade predlog odluke o Ekološkoj Saglasnosti.</p> <p style="text-align: center;">Član 17 Rezultat pregleda prateće dokumentacije i izveštaja PUŽS</p> <p>1. Komisija za PUŽS u roku od dvadeset (20) dana od dana održavanja javne rasprave, razmatra primedbe i mišljenja proizašla iz javne rasprave, kao i odgovore koje daje sastavljač.</p> <p>2. Komisija za PUŽS može od podnosioca zahteva zatražiti kompletiranje dokumentacije, za izmenu ili dopunu određenih elemenata izveštaja PUŽS, koji je podnet.</p> <p>3. Podnosilac zahteva mora kompletirati dokumentaciju u roku od trideset (30) dana. Doke se tražene izmene treba da bude u skladu sa stavom 2 ovog člana koje moraju izvršiti u roku od deset (10) dana i dostaviti izveštaj PUŽS, izmenjen i završen.</p>
--	---	---

<p>4. Nëse aplikuesi nuk vepron sipas kërkesës nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, Ministria e ndërpre në procedurën e shqyrtimit.</p>	<p>4. If the applicant does not act upon the request from paragraphs 2 and 3 of this Article, the Ministry terminate the examination procedure.</p>	<p>4. Ako podnosilac zahteva ne postupi po zahtevu iz stava 2 i 3 ovog člana, Ministarstvo obustavlja postupak razmatranja</p>
<p style="text-align: center;">Neni 18 Vendimi për pëlqim mjedisor</p>	<p style="text-align: center;">Article 18 Decision on environmental consent</p>	<p style="text-align: center;">Član 18 Odluka o ekološkoj saglasnosti</p>
<p>1.Vendimi për pëlqim mjedisor përmban informata për:</p>	<p>1. The decision for environmental consent contains information on:</p>	<p>1. Odluka o saglasnosti za životnu sredinu sadrži informacije o:</p>
<p>1.1. Konkluzionin e arsyetuar të efekteve të rëndësishme të projektit në mjedis duke marrë parasysh rezultatin e shqyrtimit të raportit të VNM-së, informatat shtesë si dhe çdo informatë përkatëse të marrë gjatë procesit të konsultimit me publikun dhe autoritetet relevante të interesuara dhe kur është e përshtatshme ekzaminimin plotësues.</p>	<p>1.1. Reasoned conclusion of the significant effects of the project on the environment, taking into account the result of the examination of the EIA report and any supplementary information provided as well as any relevant information received through the consultation process with the public and relevant authorities concerned and where appropriate its own supplementary examination.</p>	<p>1.1. Obrazložen zaključak o značajnim uticajima projekta na životnu sredinu, uzimajući u obzir rezultat razmatranja PUŽS izveštaja, dodatne informacije kao i sve relevantne informacije dobijene tokom procesa konsultacija sa javnošću i relevantnim nadležnih organima, i tamo gde je potrebno sopstveno dodatno ispitivanje.</p>
